



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1108/2 prot.,

Datë 08.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-98176-03-12-2024, me objekt: “*Grumbullim, trajtim, asgjësim i mbetjeve spitalore* ” me fond limit 35,696,940 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Elbasan.

Ankimues: Operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, me NUIS L28029301Q, me adresë: Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit, Kurbin

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Elbasan,

Në datën 07.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1108/2024 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4054 e operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-98176-03-12-2024, me objekt: “*Grumbullim, trajtim, asgjësim i mbetjeve spitalore* ” me fond limit 35,696,940 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Elbasan.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 1108 prot., datë 07.05.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“Dokumenti i Lejes mjedisore e tipit A me kod III.IC, e paraqitur nga ana juaj është e pezulluar nga AKM ne momentin e zhvillimit te kesaj procedure prokurimi, sipas deklarates paraqitur nga vete operatori, duke mos plotesuar Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapciteti Teknik pika 2.a..”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 08.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri